# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-418451**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ministri rus rikthehet në tryezën e G20-s, Evropa proteston – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/ministri-rus-rikthehet-ne-tryezen-e-g20-s-evropa-proteston/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 23:34:31 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 1 shtator 2026, 07:50:22 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1b8601bf37dbfb7d7592e5493ff728da67106b300a21b25b4c7cd6759ef2961c` |
| TEKSTI | `7a77b0003e80c30b16a70268fa2182ccb0ac84ea7b692c04d835908da60f0dd6` |
| PAMJA | `5c69a8ff4310c5a2aea9109bde556f8d18fe5aa4d37ea665a3ac1d1b6c68795b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8a18946ca400fbd9058e9a8b990d2d6f9303fd0ad3df65f6880a5754f5616ff3` |
| E MËPARSHMJA | `348d632d07d36a12a6b0773ca0b5e43513aa848c94eb938b2ba55a56641f7cb1` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8a18946ca400fbd9058e9a8b990d2d6f9303fd0ad3df65f6880a5754f5616ff3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

edhe ministri rus i Financave, Anton Siluanov, me ftesë të Shteteve të Bashkuara, të cilat mbajnë aktualisht presidencën e G20-s. Kjo ka shkaktuar kritika.

5 Rama uron nisjen e vitit të ri shkollor: Një vit të mbarë për nxënësit,...

NEWSLETTER
Përmbledhja e ditës në e-mail
emaili juaj
Abonohu

Vendet evropiane të G20-s reaguan me zemërim dhe refuzuan të dilnin në një fotografi të përbashkët. Fotografia e ashtuquajtur familjare u realizua më pas pa ministrin rus të Financave. “Veprimi i përbashkët i evropianëve, për të cilin jam shumë mirënjohës, bëri që në fund kjo foto familjare të realizohej pa ministrin rus të Financave dhe pa delegacionin rus”, tha ministri gjerman i Financave, Lars Klingbeil, në Asheville.

## “Nuk duhej pritur si një mysafir i zakonshëm”

Fakti që, për herë të parë që nga fillimi i luftës së agresionit kundër Ukrainës, një ministër rus i Financave ishte sërish i pranishëm personalisht në takim, u vlerësua nga Klingbeil si një”përpjekje për normalizim” nga ana e SHBA-së, vendit mikpritës. Ai theksoi se nuk sheh asnjë arsye për një zbutje apo normalizim të marrëdhënieve me Rusinë në rrethanat aktuale. Sipas tij, duke pasur parasysh luftën brutale që Rusia po zhvillon kundër Ukrainës, ai do të kishte pritur më shumë qartësi nga amerikanët si organizatorë të takimit. Ministri rus, tha Klingbeil,”nuk duhej pritur si një mysafir i zakonshëm.”

Megjithatë, edhe pse nuk pati një fotografi të përbashkët me Siluanovin, u zhvilluan takime të përbashkëta. Sipas ministrit gjerman të Financave Klingbeil, ai i shfrytëzoi ato për të përcjellë mesazhe të qarta, duke i përcjellë “drejtpërdrejt në sy ministrit rus, se qeveria ruse duhet t’i japë

fund kësaj lufte". Gjithashtu, ai kishte bërë të qartë se Gjermania do të vazhdojë ta mbështesë Ukrainën.

"Nganjëherë këto takime më duken tepër diplomatike dhe ndoshta fjalët e mia kanë habitur një ose dy persona në sallë", tha ai. Njëkohësisht, Klingbeil theksoi se"Rusia është pjesë e G20-s dhe, në këtë kuptim, është mirë që ekziston mundësia e dialogut dhe që aty të thuhen fjalë të qarta."

## Shtëpia e Bardhë mbron ftesën për Rusinë

Shtëpia e Bardhë ka mbrojtur ndërkohë ftesën e bërë ndaj Rusisë për samitin e G20-s në një deklaratë për agjencinë e lajmeve AFP. Sipas zëdhënësit Kush Desai, administrata amerikane po punon me Moskën për një marrëveshje që do t'i japë fund"gjakderdhjes së pafund" në Ukrainë. "Presidenti dhe administrata nuk do të hezitojnë kurrë të bisedojnë me njerëzit me të cilët duhet të flasim për ta çuar përpara këtë proces", tha Desai.

Takimet e ministrave të Financave shërbejnë si përgatitje për samitin kryesor të krerëve të shteteve dhe qeverive, i cili do të mbahet në dhjetor në Miami. Presidenti rus Vladimir Putin mori pjesë për herë të fundit në një takim të tillë ndërkombëtar në vitin 2019. Kjo mund të ndryshojë së shpejti. Presidenti amerikan Donald Trump u shpreh që në prill në parim pozitivisht për një pjesëmarrje të mundshme të Putinit. "Nëse ai do të vinte, kjo me shumë gjasa do të ishte e dobishme", tha Trump. "Unë jam i mendimit se duhet të bisedohet me të gjithë."/DW

#G20 #Rusi

**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

### Vazhdo të lexosh




BOTA
**Sulm me dron ndaj një anijeje ruse në Detin...**
Xhuljana Zhuleku · 30 minuta më parë



BOTA
**Trump i kërkon Zelenskyt të...**
Xhuljana Zhuleku · 1 orë më parë



BOTA
**Tragjedi! Përmbyset anija me pasagjerë,...**
Xhuljana Zhuleku · Dje 23:17

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

• LIVE

**Lajme**
Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

**Programe**
Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.